

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL VITI

Për Aktivitetin e Prokurimit: 657-26-3031-1-2-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me pajisje speciale mjeksore

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Pro Medical"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kadri Zeka

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049-631-245

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Adnan Bala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

promedical.fr@gmail.com

(Adresa elektronike)



13.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 04.05.2026
Hapja e ofertave 27.05.2026
Letrat standarde 27.06.2026 pra Vendimi AK
Vendimi per Refuzimin e Kërkeses per Rishqyrtim 03.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura të LPP-se:

Neni 1 – Qellimi

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si palë e interesuar – në përputhje me kuptimin e pikës 1.26 të nenit 4 ne paraqesim këtë Ankesë duke u bazuar në LPP dhe Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024 Neni 60.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e dy operatorëve ekonomikë, BRT Pharm SH.P.K dhe KONTI Në përgjigje, Autoriteti Kontraktues (AK) me datë 30.06.2026 na ka dhënë qasje të plotë vetëm për dokumentet e BRT Pharm SH.P.K, ndërsa për KONTI na ka ofruar qasje [në përjashtime të file 4.Katalogu.pdf pra te OE KONTI](#) dhe kemi ketë email nga AK [“Ne e kemi ngarkuar edhe file 4,te OE KONTI, por per shkak te volumit nuk ka percjell e-maili”](#) por ne kemi vrejtur se nuk është disponueshëm në e-prokurim.

Dokumentet tjera

Dërguar në: KUVENDI KOMUNAL VITI
Dokumenti për dërgim te AK
Kerkesa per qasje-1.pdf
26.06.2026 15:29
Hape:
Ngarko:

Dërguar në: KUVENDI KOMUNAL VITI
Dokumenti për dërgim te AK
Kerkese per qasje KK Viti.pdf
30.06.2026 14:40
Hape:
Ngarko:

Dërguar nga : KUVENDI KOMUNAL VITI
Dokumenti për dërgim te OE
PERGJIGJE.QASJA. PROMEDICAL.docx
30.06.2026 14:08
Hape:

Për më tepër, ju lutemi të shikoni edhe e-mailin e bashkëngjitur kësaj ankese, nga i cili mund të verifikoni se cilat dokumente i kemi pranuar nga AK për OE KONTI .

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës- OE Pro Medical nuk është dorzuar dokumente e plotë për OE KONTI sidomos file potencuar si file 4.Katalogu.pdf pra te OE KONTI me saktësisht në dosjen e operatorit te katalogun për produkteve /pasjeve me te cilat ka ofertuar, përmes te cilit përcaktohet nëse ai është i përgjegjshëm apo jo.

OE KONTI nuk ka plotësuar **Aneksi 3-KËRKESA PËR SEKRET AFARIST**, Autoriteti Kontraktues ka qene i obliguar që të dërgoj edhe këtë file por nuk e ka bërë edhe pse se na informon se ka ngarhuar ne e-prokurim po kjo nuk qëndron.

Kjo ne përputhje me paragrafin 3 te Nenin 11. Andaj, edhe pse informata se me çfarë produkte /paisjet ka ofertuar ne asnjë rast nuk mund te jete konfidenciale, Autoriteti Kontraktues ka qene i detyruar që të na dërgoj dokument e plotë të OE KONTI.

E kundërshtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 03.07.2026 ngase i njeiti eshte ne kundërshti me nenin 59 te Ligjit per Prokurim Publik sepse nuk ka marre ne konsiderate detyrimin sipas LPP Neni 59.

Pretendimi 1 per OE "BRT Pharm SH.P.K"

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve -Gjatë procesit të vlerësimit të, AK nuk ka respektuar dispozitat e Nenit 59 të LPP-së, AK ka ndërmarrë një vlerësim të ne kundërshtim me LPP Neni 59 dhe NJK.

OE BRT Pharm SHPK nuk ka dorzuar dokument e kërkuar sipas **Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME** si më poshtë:

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specififikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specififikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

- ▲ [2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet te ceke specififikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë]



SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME	
Numri i Prokurimit: 657-26-3031-1-2-1; Numri i brendshëm 657-26-016-121 – Titulli Furnizim me pajisje speciale mjeksore	
I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME TEKNIKE	
Të gjitha pajisjet që do të ofertohen duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:	
1. Kërkesat e përgjithshme	
• Pajisjet duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe të prodhimit të fundit. • Të jenë të destinuara për përdorim profesional mjekësor. • Të jenë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për pajisje mjekësore. • Prodhuesi të jetë i certifikuar me ISO 13485 ose standard ekuivalent. • Të jenë të përshtatshme për furnizim me energji elektrike 220–240V / 50Hz. • Të shogërohen me manual përdorimi në gjuhën shqipe ose angleze. • Të përfshijnë të gjithë aksesoret e nevojshëm për funksionim të plotë.	
2. Dokumentacioni teknik	
Operatori ekonomik duhet të paraqesë:	
• Katalogët teknikë origjinalë. • Deklaratën e konformitetit. • Certifikatat CE dhe ISO. • Dëshmi për autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar. • Deklaratë për garancion dhe servis.	
3. Garancioni	
• Garancioni minimal duhet të jetë 12 muaj.	

Ndërsa OE BRT Pharm SHPK në ofertën e dorëzuar nuk ka përmbushur kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT) si në vijim:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Katalogët teknikë origjinalë.
- Deklaratën e konformitetit.
- Certifikatat CE dhe ISO.
- Dëshmi për autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar.
- Deklaratë për garancion dhe servis.

3. Garancioni

- Garancioni minimal duhet të jetë 12 muaj.

Pra duke u bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të ofertës dhe për arsye të paraqitura më lartë, vërtetohet se ky operator ekonomik duhet të eliminohet nga procedura e tenderimit:

Për rrjedhojë, në përputhje me Nenin 59, paragrafin 4 citim " *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit* "

Siq kemi cekur ky OE duhet eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për shkak se nuk ka dëshmuar dhe nuk ka dorzuar dokumentet e listuar më lart dhe nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas DT pra në Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, siç është kërkuar qartë në Dosjen e Tenderit.

Dokumentet e dorzuar nga BRT Pharm SHPK

Kodi i tenderit: BRT 2026

Data: 26.05.2026

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1.Certifikate e Regjistrimit.pdf
2.	2.LICENCA.pdf
3.	3.Qarkullimi brt.pdf
4.	4.LISTA E KONTRATAVE.pdf
5.	5.Iso Standartet dhe Linku per verifikimin e isove.pdf
6.	6.Aneks-II dhe Aneks -I.pdf
7.	BRT Pharm SH.P.K.-Deklarata (1).pdf
8.	9.QMIMI.pdf

Pra, Autoriteti Kontraktues (AK) dhe Komisioni Vlerësues kanë kryer vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë dokumentet relevante dhe kërkesat thelbësore të dosjes së tenderit. Konkretisht, OE BRT Pharm i mungojnë dokumente të rëndësishme, si:

- Katalogët teknikë origjinalë.
- Deklaratën e konformitetit.
- Certifikatat CE dhe ISO.
- Dëshmi për autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar.
- Deklaratë për garancion dhe servis.
- 3. Garancioni

Pavarësisht mungesës së këtyre dokumenteve, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën e OE BTT Pharm si të përgjegjshme dhe e ka vazhduar procedurën e vlerësimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që të shqyrtojë dhe vlerësojë vetëm ofertat që plotësojnë të gjitha kërkesat administrative, profesionale dhe teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, vlerësimi i bërë nga AK nuk është në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë, pasi një operator ekonomik është kualifikuar edhe pse nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Kurse be baze Udhëzuesit të Prokurimit Publike pra 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve :

Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik") – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	28
--	--	----

Pretendimi 2 për OE "KONTI"

AK nuk na ka vënë në dispozicion katalogët ose [file 4.Katalogu.pdf pra te OE KONTI](#) teknikë dhe dokumentacionin teknik të ofertës së OE KONTI, duke na pamundësuar të verifikojmë nëse produktet /pajset e ofertuara i përmbushin specifikimet teknike të detyrueshme të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, nuk kemi pasur mundësi të konstatojmë se cilat produkte janë ofertuar dhe nëse ato janë në përputhje me kërkesat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Për më tepër, AK në e-mailin e bashkëngjitur kësaj ankese pretendon se dokumentet përkatëse janë ngarkuar në platformën e e-Prokurimit, megjithatë ky file nuk ngarkuar dhe nuk na është dërguar, pasi nga verifikimi i bërë në platformën e e-Prokurimit rezulton se dokumentet në [fjalë nuk janë ngarkuar fare](#) dhe nuk kanë qenë të qasshme për ne pra Pro Medical.

Si dëshmi për këtë pretendim, bashkëngjisim e-mailin e Autoritetit Kontraktues, si dhe referencat përkatëse nga platforma e e-Prokurimit, nga të cilat vërtetohet se dokumentacioni i **përmendur nuk ka qenë i publikuar apo i qasshëm**. Për pasojë, pretendimi i AK-së se dokumentet janë ngarkuar në e-Prokurim nuk përputhet me gjendjen faktike dhe ka pamundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës sonë për verifikimin e ofertës dhe për paraqitjen e një ankese të argumentuar.

Re: Kerkese per qasje ne tenderin Furnizim me pajisje speciale mjeksore

PV Prokurimi Viti <Prokurimi.Viti@rks-gov.net>
To promedical.fr@gmail.com



Pershendetje,

Ne e kemi ngarkuar edhe file 4,te OE KONTI, por per shkak te volumit nuk ka percjell e-maili.

Nga e-prokurimi.

Dokumentet tjera

Kjo mungesë e dokumentacionit ka cenuar të drejtën tonë për një mjet juridik efektiv, pasi na është pamundësuar të bëjmë një vlerësim të plotë të ofertës së OE KONTI dhe të identifikojmë nëse ajo i përmbush apo jo kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Përkundrazi, AK ka qenë i obliguar t'i vërë në dispozicion të gjitha dokumentet e ofertës së OE KONTI, përfshirë katalogët teknikë, specifikimet teknike dhe dokumentet e tjera mbështetëse. Mosveprimi i AK-së ka cenuar parimin e transparencës, trajtimin të barabartë dhe të drejtën tonë për të ushtruar një ankesë efektive.

Po ashtu, në Dosjen e Tenderit është kërkuar shprehimisht që **Aneksi 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme** të plotësohet të vuloset dhe të nënshkruhet nga operatori ekonomik. Ky aneks përmban specifikimet teknike të detajuara të pajisjeve të kërkuara nga AK dhe shërben si dokumenti përmes të cilit operatori ekonomik deklaron dhe dëshmon se produktet e ofertuara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

VULOS DHE NENSHKRUAJ	
[Indikacion për ndryshimin e datës së fillimit/dorëzimit (nëse zbatohet):]	
[Fillimi:]	< shëno datën >
[Dorëzimi:]	< shëno datën >

Pra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se OE KONTI nuk e ka dorëzuar **Aneksin 1** të plotësuar, të vulosur dhe të nënshkruar, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, por vetëm një **deklaratë të përgjithshme dhe një deklaratë e tillë** nuk mund të zëvendësojë **Aneksin 1, pasi nuk përmban specifikimet teknike të secilës pajisje të kërkuar dhe nuk dëshmon përputhshmërinë e produkteve të ofertuara me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit.**

Për rrjedhojë, mungesa e Aneksit 1 përbën mospërmbushje të një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit dhe e bën të pamundur verifikimin objektiv të përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Kjo mangësi është dashur të konstatohej nga Komisioni Vlerësues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe të trajtohej në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, e jo të konsiderohej si një mangësi e parëndësishme.

Përkundër këtyre mangësive, AKs e ka konsideruar ofertën e OE KONTI si të përgjegjshme, duke vepruar në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk ka bërë një vlerësim të bazuar në përmbushjen e plotë të kërkesave administrative dhe teknike të Dosjes së Tenderit.

Kjo përbën mosplotësim të kriterëve administrative dhe si rrjedhojë, ky operator:

- Nuk ka përmbushur kriteret DT përkatëse;

Në bazë të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, konstatohet se Operatori Ekonomik i plotëson kërkesat DT dhe **duhet të eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.**

VENDIMI

Aprovohet Kërkesa për Rishqyrtim si e bazuar e OE " Pro Medical"
Dhe lenda të Ri-kethen ne ri-vlersim.

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e AK, përkatësisht **eliminimi i ofertës sonë në mënyrë të pajustificuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik**, na kanë shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme dhe të drejtpërdrejta.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- a) *Te gjitha dokumentet relevante jane ne e-prokurimi*